



# Dahlia



## Estetiste për trajtimin e thonjve

Përshkrimi i pozicionit të punës:

Dahlia është në kërkim të një estetisteje për trajtimin e thonjve me eksperiencë, kreative, të apasionuar pas profesionit të saj, të informuar dhe të interesuar për trendet e momentit dhe me aftësi shumë të mira komunikimi. Estetistja duhet të bëjë trajtime të duarve dhe këmbëve, manicure, pedicure, vendosjen dhe mbushjen e thonjve, kurimin e thonjve të dëmtuar dhe stilime të thonjve. Gjithashtu estetistja duhet të ketë njohuri dhe eksperiencë në depilimin me dyll.

### Detyrat kryesore:

- Të vendosë dhe mbushë thonjë me xhel dhe akrilik duke përdorur mjetet dhe pajisjet përkatëse
- Të bëjë manicure dhe pedicure
- Të stilojë thonjtë me dorë të lirë gjithashtu duke përdorur teknika dhe mjete të ndryshme
- Të dijë të trajtojë thonjtë dhe lëkurën e dëmtuar të duarve dhe këmbëve
- Të këshillojë klientët për mirëmbajtjen e thonjve dhe lëkurës së duarve dhe këmbëve
- Të bëjë depilim me dyll të të gjithë pjesëve të trupit

### Cilësitë personale:

- Mos të ketë alergji nga produktet kozmetike që përdoren
- Të ketë sjellje të qetë e të duruar
- Të ketë paraqitje të rregullt dhe të kuruar
- Të jetë diskrete në lidhje me trajtimet dhe shërbimet që i ofron klientëve
- Të ketë aftësi shume të mira komunikuese
- Të ketë aftësi krijuese dhe artistike

### **Kualifikimet profesionale:**

- Të ketë përfunduar me sukses shkollimin e duhur për estetikë për trajtimin e thonjve
- Të ketë të paktën 2 vjet eksperiencë
- Gjuhët e huaja janë një aset që do të merret në konsideratë

*Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për intervista.*

*Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke dërguar CV-në e tyre me foto në adresën e e-mail-it [dahliacenter@hotmail.com](mailto:dahliacenter@hotmail.com) duke specifikuar pozicionin për të cilin po aplikojnë, **deri në datën 19 Shkurt 2016.***

***Dahlia. Feel Better!***